

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org.
 Org.Jedinica
 Org.Unit 1000

Nr.Prot:
 Broj.Prot:
 Prot.No. 2741-2/26

Nr. i faqeve
 Broj.stranica
 No. pages 104-

Data:
 Datum: 15.06.2026

PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
 Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit / Department of Environment Protection /
 Departament za Zaštitu Sredine

DATE/A:	15.06.2026
REFERENC-Ë:	26/2741/MMPH/451/DMM
PËR/ZA/TO:	"MetBat" Sh.p.k., Malet e Krivoves-Glogoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Miradije Gërguri, U.D. Drejtore e DMM-së Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Ekrem Hetemi, Zyrtar i Lartë për Mbeturina
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Leje për Eksport të Mbeturinave

Sipas kërkesës së juaj me nr. prot. 26/2741/MMPH/451/DMM, datë 18.05.2026, MMPH ka shqyrtuar kërkesën dhe ka vendosur si në vijim.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 29 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024 për Përcaktimin e Kushteve, Kritereve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Transzit të Mbeturinave, nenit 40, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina si dhe nenit 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nxjerr këtë:

VENDIM

Aprovohet kërkesa e kompanisë “MetBat” Sh.p.k., Malet e Krivoves-Glllogoc, me nr. prot. 26/2741/MMPH/451/DMM, datë 18.05.2026, për Leje Eksporti të Mbeturinave në kompaninë:

1. “TEKNOMETAL” S.R.L. DOOEL

Adresa: Skopski Pat br.13-Dereboj, Tetove/Republika e Maqedonisë së Veriut.

Nr. i Notifikimit: RKS 0047/2741-451/26

Lloji dhe sasia e mbeturinave

Lloji mbeturinës	Kodi sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave	Sasia/ton
Bakri, bronzi, tunxhi; Alumini	17 04 01; 17 04 02	1,500

Faqe 2 nga 4



Origjina e mbeturinave: Republika e Kosovës.

Vlefshmëria e lejes: Leja është e vlefshme nga data 15.06.2026 deri më 30.04.2027.

Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e mbeturinave duke iu përmbajtur kushteve të Marrëveshjes Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR) dhe Rregullave në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme me hekurudhë (RID).

Kompania është e detyruar që t'iu dërgoj kopjet e nënshkruara të dokumentit shoqërues të autoriteteve kompetente përkatëse të paktën tri (3) ditë pune para datës së fillimit të dërgesës.

Kompania në fjalë, është e obliguar ta njoftoj MMPH-në me shkrim, për realizimin e eksportit të mbeturinave në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Kompania në fjalë është e obliguar të përmbahet Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave për eksportimin e mbeturinave për të cilat lëshohet kjo leje.

Bashkangjitur në këtë vendim gjeni:

- Dokumentin për Notifikim lidhur me qarkullimin ndërkufitarë të mbeturinave.



ARSYETIM

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot. . 26/2741/MMPH/451/DMM, datë 18.05.2026, të kompanisë "MetBat" Sh.p.k., Malet e Krivoves-Glllogoc, për Leje Eksporti të Mbeturinave:

Vlerëson se nga kompania janë prezantuar dokumentet dhe shënimet e nevojshme sipas nenit 5, 6, 7, 10, 15 dhe 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2024, për Përcaktimin e Kushteve, Kriteve dhe Procedurave për Lëshimin e Lejes për Import, Eksport dhe Kalim Tranzit të Mbeturinave dhe sipas nenit 56 të Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina dhe i lëshohet Leja për Eksport të Mbeturinave.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e lëshimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. 2741 /26-ZSP/

/26,

datë: 15.06.2026

Prishtinë

Vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Zyrës së Sekretarit
3. DMM-së
4. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
5. Inspektoratit të MMPH-së
6. Kabinetit të Ministrit/es
7. Arkivit të MMPH-së



U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të
MMPH-së